



Bashkë-financuar
nga Bashkimi Evropian

Bashkë-financuar nga Agjensia
Ndërkombëtare Suedeze për
Zhvillim dhe Bashkëpunim



Sweden
Sverige

RAPORT MONITORUES

MJEDISI DHE GJINIA

BASHKIA VLORE

Nëntor 2022



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



Bashkë-financuar
nga Bashkimi Evropian

Bashkë-financuar nga Agjensia
Ndërkombëtare Suedeze për
Zhvillim dhe Bashkëpunim



Sweden
Sverige

Ky Raport monitorues është hartuar në kuadrin e projektit "***Krijimi i Aleancave Lokale Feministe Mjedisore***", që implementohet nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe mbështetet nga Reactor - Research in Action dhe partnerët e tyre përmes Aksionit "***Përparimi i Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE***". Ky Aksion financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe është bashkëfinancuar nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo të Agjensisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Përgatitur nga:

Qendra Rinore e Vlorës, Vlorë

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE.....	4
BASHKIA VLORË	4
KUADRI LIGJOR	6
STRATEGJIA MJEDISORE	8
ANALIZË E OBJEKTIVAVE DHE PËRMBUSHJA E TYRE NGA BASHKITË.....	8
GJETJET NGA TAKIMET ME KOMUNITETIN	14
KONKLUZIONE	15
REFERENCA.....	17

Hyrje

Gjatë vitit 2022 Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" zhvilloi projektin Krijimi i Aleancave Feministe Lokale dhe Mjedisore. Projekti mbështetet nga "Reactor Research in Action" dhe partnerët e tyre përmes Aksionit "Përparimi i Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE". Ky Aksion financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Agjensia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Projekti kishte për qëllim mbështetjen e organizatave locale të grave në avancimin e kapaciteteve të tyre në gjini dhe mjedis duke përdorur një qasje të "të mësuarit duke bërë" dhe të adresojë në mënyrë efikase çështjet mjedisore nga një perspektivë gjinore.

Për këtë arsye në bashkëpunim me grupet qytetare dhe organizatat lokale, u përqendruam në Kamëz, Pukë dhe Vlorë. Gjatë ciklit të projektit, më shumë se 400 gra dhe vajza u bënë pjesë e takimeve të roganizuara për advokacinë mjedisore; më shumë se 60 të rinj u trajnuan mbi gjininë dhe mjedisin dhe rreth 50 zyrtarë të pushtetit vendor u bënë pjesë e takimeve tona. Tre Aleanca Mjedisore Feministe Lokale u ngritën, duke u bërë kështu zëri i grave dhe vajzave në të tre bashkitë për advokimin e çështjeve mjedisore dhe lidhjen e tyre me mjedisin.

Në vijim, organizatat partnere monitoruan bashkitë respektive dhe dolën me këtë raport monitorues sa i përket situatës aktuale në Pukë, Vlorë dhe Kamëz me qëllim përmirësimin e treguesve mjedisorë në secilën prej bashkive, veçanërisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve, ndotjes dhe riciklimit.

Bashkia Vlorë

Bashkia e re e Vlorës kufizohet në veri me bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Selenicë dhe në jug me bashkinë Himarë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Vlorës. Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Vlorës dhe qarkut të Vlorës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra¹. Në këtë territor shtrihen tre qendra të rëndësishme të turizmit detar, Vlora, Radhima dhe Orikumi, ndërsa bashkisë i shtohen edhe zonat rurale blegtorale të Tragjasit. Kjo zonë ka në përbërje dhe parkun detaro-bregdetar Sazan-Karaburun, që është i vetmi i këtij lloji në vedin tonë. Zona ka praninë e minorancave etnike, përkatësisht minorancës Greke në zonën e Nartës dhe asaj rome në Novoselë. Bashkia e re e Vlorës ka një sipërfaqe prej 616.85 km². Nëse merren parasysh të dhënat e censusit, densiteti i popullsisë në këtë bashki është 169.9 banorë për km² ndërsa sipas të dhënave të regjistrimit civil, densiteti është 314.73 banorë për km².

Qyteti i Vlorës ka një aktivitet të vogël tregtar përmes Portit të Vlorës, i cili ka përpunuar mesatarisht 69 mijë tonë mallra nga 2013-2019, rreth 1.6% të volumit të mallrave të

¹ <https://pushtetivendor.reporter.al/wp-content/uploads/2015/05/Bashkia-Vlore.pdf>

përpunuara nëpër portet shqiptare². Vlora ka si burim kryesor ekonomik turizmin dhe bujqësinë e përqendruar te blegtoria dhe ullinjtë. Si një qytet bregdetar, Vlora është edhe një qendër e rëndësishme e peshkimit. Në këtë territor gjenden tre qendra të rëndësishme të turizmit detare, Vlorë dhe Orikum, Radhime. Kjo zonë përfshin edhe parkun bregdetar të Sazan-Karaburunit, i cili është i veti i këtij lloji në Shqipëri. Gjiri i Vlorës është i njohur për burimet e tij natyrore, biodiversitetin e pasur dhe korridoret ekologjike. Është ndër zonat me mundësi të zhvillimit të turizmit me të lartë të mundshëm në vendit, e cila është e lidhur me daljen direkte në det, klimën, ujin, arkeologjin, morfologjik, historike, kulturore, njerëzore dhe asetet ekonomike.

Qëllimi i Bashkisë Vlorë për Mjedisin:

Bashkia Vlorë ka ndërmarrë një fushatë disa vjeçare me fokus në pastrimin e zonave të ndotura, përfshirë ato bregtare, qytetase, rurale, etj. Bashkia Vlorë has vështirësi të mëdha të mbrojtjes së mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi i tij. Një nga problemet më të mëdha të bashkisë Vlorë është dhe menaxhimi i pastrimit të qytetit gjatë sezonit turistik. Zona e bregdetit të Vlorës, por së fundmi dhe turizmi malor, janë dy faktorë kryesorë që e kthejnë bashkinë e Vlorës si një nga destinacionet turistike më të rëndësishme në vend. Nga totali i mbetjeve urbane, bashkia Vlorë prodhon 122,463-ton në vit³.

Bashkia ka si qëllim të shtojë masat e kontrollit në zonat ku banorët kryejnë djegie të mbetjeve, kryesisht plastika, nëpërmjet metodave informale. Gjithashtu një vëmendje të veçantë kërkon dhe bonifikimi i pikës së grumbullimit të mbetjeve.

Sipas një studimi të publikuar nga ECO Albania⁴, në bashkinë Vlorë, por dhe specifikisht përgjatë vijës së bregdetit janë evindentuar keto problematika mjedisore:

- Presion i lartë në ekosistemin bregdetar për shkak të urbanizimit të lartë dhe zhvillimit të strukturave akomoduese të turizmit.
- Turrja e zonave të mbrojtura në rezervatin natyror të mbrojtur Vjosë-Nartë për ndërtimin e aeroportit dhe infrastrukturën mbështetëse të tij.
- Keqmenaxhimi i mbetjeve në plazhet e bregdetit.
- Ndotja potenciale detare nga aktiviteti portual dhe hidrokarburet në Vlorë.
- Ndotja detare nga feramat e rritjes së peshkut në Karaburun, Porto Plaermo.
- Shpyllëzimi i pyllit të Sodës.
- Ndotja nga keqmenaxhimi i ujrave të ndotur dhe kanalizimeve urbane.
- Shfrytëzimi i i paligjshëm i shtratit të lumenjve dhe erozioni i lartë bregdetar.

Përtej Bashkisë, një nga kategoritë e votuara më shumë nga qytetarët për ndarjen e buxhetit vjetor është për : Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike me 34%, Mbrojtja e Mjedisit me 12%, dhe Arsimi me 12%.

² <https://www.portivlore.com/index.php/statistika/>

³ Ministria e Zhvillimit Urban. Vizioni dhe Strategjia Territoriale. Narrativë e përbashkët për qarkun Vlore, Durrës, dhe Lezhë.

⁴ <https://www.ecoalbania.org/sq/2022/02/09/mbetjet-urbane-si-problematike-mjedisore-ne-bregdet/>

Kuadri Ligjor⁵

Kuadri Ligjor per vetqeverisjen vendore, i targeton bashkive pergjegjesi edhe në çështjet mjedisore:

Në varësi të kuadrit ligjor nr 139/2015⁶, për **ligji i Vetqeverisjes vendore**, nenet që mbulojnë përgjegjësinë juridike të institucioneve mbi mbrojtjen e mjedisit.

Neni 23: Bashkia ushtron funksionin publik për të garantuar infrastrukturën e duhur të shërbimeve publike në: prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm; menaxhimin e plotë të ujërave të ndotura, dhe të ujërave të shiut duke siguruar mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara.

Neni 26: I targeton Bashkive përgjegjësinë mbi sigurimin e masave mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës, dhe ujit nga ndotja, por gjithashtu dhe marrjen e masave mbrojtëse nga ndotja akustike. Më tej, bashkitë kanë detyrim të zhvillimit të aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, rreth çështjeve të mbrojtjes së mjedisit.

Neni 27: Bashkitë kanë përgjegjësi në administrimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të zotëruar në pronësi të tyre sipas ligjit. Bashkitë ndërmarrin administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore dhe burimeve të kategorive të tjera. Bashkia garanton krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe të këshillimit bujqësor e rural. Bashkia ndërmerr nismën e krijimit dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas ligjit. Bashkia krijon dhe administron skemat vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, duke garantuar akses të balancuar gjinor.

Nga ana tjetër gjendet edhe një kuadër ligjor kombëtar mbi mjedisin, i përmbledhur si më poshtë:

- Ligj Nr.10 431⁷, datë 9.6.2011 “PËR MBROJTJEN E MJEDISIT” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij
- Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”. VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, kushtet e lejeve respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.
- Ligji nr.8906, datë 06.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- Ligji nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, ndryshuar me Ligjin nr. 69/2014.

⁵ Kuadri ligjor i përmbledhur (që vesh me përgjegjësi bashkitë)

⁶ https://www.ERRU.AL/doc/Ligj_nr.139-2015_datë_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf

⁷ <https://portavendore.al/cbenbashkia/mbrojtja-e-mjedisit/>

- Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”. 5.1 VKM nr. 866, datë 10.12.2014 “Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për komunitetin evropian”.

LIGJ Nr 10 431 datë 9.6.2011PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

- *KA SHFUQIZUAR: Ligjin nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për Mbrojtjen e mjedisit” (i përditësuar), i ndryshuar*
- **LIGJ Nr. 10 448, datë 14.7.2011 PËR LEJET E MJEDISIT**
- I ndryshuar me: ligjin nr.44/2013
- ligjin 60/2014, i përditësuar
- **LIGJI Për burimet e rinovueshme 138/2013 (I përditësuar)**
- I Ndryshuar me:ligjin nr. 26, datë 20.3.2014
- Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për Transportet rrugore” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 8908, datë 06.06.2002
- Ligjin Nr. 9096, datë 03.07.2003
- Ligjin Nr. 9373, datë 14.04.2005
- Ligjin Nr. 9760, datë 21.06.2007
- Ligjin Nr. 10 137, datë 11.5.2009
- Ligjin Nr. 10 302, datë 15.7.2010
- Ligjin nr. 21/2013, date 14.2.2013 FZ 29
- Ligjin nr.37/2014, date 10.4.2014 FZ 63
- Ligji nr. 9734, datë 14.5.2007 “Për Turizmin” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 9930, datë 09.06.2008
- Ligjin 76/2013 datë 14.2.2013 fz 31
- Ka Shfuqizuar: Ligji nr. 7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar
- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për Zonat e mbrojtura” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 9868, datë 04.02.2008
- Ligji nr. 9362, datë 24.3.2005 “Për Shërbimin e mbrojtjes së bimëve” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 9908, datë 24.04.2008
- Ka Shfuqizuar: Ligjin nr. 7662, datë 19.1.1993 “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve
- Ligji nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për Mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 10 137, datë 11.5.2009
- Ka Shfuqizuar: Ligjin nr.7707, datë 17.5.1993 “Për mbrojtjen nga zjarri”
- Ligji nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për Administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”. (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 10 137, datë 11.5.2009

- Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (Ipërditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligj nr. 32/2013 datë 14.2.2013 FZ 30
- Ligj nr. 156/2013, date 30.5.2013, FZ 172
- Ka Shfuqizuar:
- ligjin nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin e mbetjeve të ngurta”
- ligjin nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”

Strategjia mjedisore

Analizë e objektivave dhe përmbushja e tyre nga bashkitë

Në kuadër të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, Vlorë bën pjesë si qytet i rëndësishëm primare në polin Vlorë-Fier-Berat. Sfidat kryesore të bashkisë Vlorë është fuqizimi i kapacitetit të tyre si një pol ekonomik miqësor ndaj zhvillimit të biznesit, i bazuar në transport publik efikas dhe që ruan karakteristikat fizike të peizazhit natyror. Nxitja e përmirësimit të mjedisit vjen dhe si një iniciativë e qeverisë Shqipëtare “Për një Shqipëri të Pastër”. Për sa i përket bashkisë Vlorë, ky program lidhet dhe me politikat e desifikimit të zhvillimit urban dhe korridoret natyrore përgjatë luginave dhe lumenjeve. PPK ka si qëllim mbrojtjen nga përdorimet e ndaluara të hapësirës së brezit bregdetar, të përcaktuar sipas legjislacionit sektorial për mbrojtjen e burimeve ujore, monitorimin e aktiviteteve për shfrytëzim ekonomik në hapësirën e brezit bregdetar, dhe rigjenerimin e korridoreve natyrore që shoqërojnë rrjedhjet lumore⁸.

Mbi bazën e parashikimit të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, Bashkia Vlorë si pjesë e polit Vlorë-Fier- Berat, i cili shihet si dyti nga rëndësia ekonomike në rang kombëtar, zotëron potenciale kryesore natyrore si: laguna e Nartës, porti i Vlorës, vija e pastër bregdetare, lumi Vjosë, etj. Ndër propozimet strategjike të polit Vlorë-Fier-Berat, ato që prekin drejtpërsëdrejti bashkinë e Vlorës lidhen me:

- Përmirësimi i kushteve dhe fuqizimi i kapacitetit akomodues të portit të Vlorës dhe Petroliferës, si nyjat portuale kryesore të transportit detar.
- Ndërtimi i rrugës bregdetare peizazhistike, përgjatë qendrave: Divjakë- Pishë Poro-Nartë- Vlorë- Dhërmi.
- Lidhja e TAP-it me HEC-in e Vlorës, në mënyrë për ta bërë funksionale edhe këtë vepër energjetike, me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit për jugun e vendit.
- Projekti i linjës së gazit Fier-Vlorë, për furnizimin e “Vlorë Thermal Power Plant” është parashikuar për t’u hartuar si projekt teknik.
- Vlerësimi i mundësive nga sektorët përkatës për ripërdorim të termocentraleve ekzistues apo të rinj, që përdorin energjinë nga gazi.

- Vlerësimi i potencialit natyror në aspektin e diversifikimit të energjisë së rinovueshme dhe asaj alternative, duke konsideruar rrezatimin prej 2700 orë/vit për ndërtimin e parqeve fotovoltaike.

Njëkohësisht, kuadri ligjor për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i cili ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qendrueshëm, detyron

Kuadri ligjor i VSM-së përfshin në mënyrë të detyrueshme Ligjin Shqiptar për VSM-në, ndërkohë që, për të qenë koherent, nuk është lënë mënjanë edhe kuadri ligjor ndërkombëtar. Referencat perkatese ligjore janë dhene me poshte: Ligji nr. 91/2013 “Per Vleresimin Strategjik Mjedisor”, i cili ka per qellim te siguroje mbrojtje te larte te mjedisit dhe zhvillim te qendrueshem, permes perfshirjes se ceshtjeve te mjedisit gjate hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit te planeve a programeve me pasoja te mundshme negative ne mjedis. Ligji percakton institucionet dhe autoritete perkatese, detyrat dhe pergjegjesite e tyre, si dhe rregullat e procedures per kryerjen e Vleresimit Strategjik Mjedisor. Ligji eshte perafruar me Direktiven 2001/42/KE, date 27 qershor 2001.⁹

Çështjet mjedisore në Bashkinë Vlorë.

Gjëndja e mjedisit dhe përkujdesjet ndaj tij janë ndër problemet dhe sfidat më të mëdha të njerëzimit sot. Zhvillimi ekonomik i cili po shoqërohet me rritje të vazhdueshme të numërit të ndërmarrjeve operuese, ndërtimin e objekteve të reja, lidhjet infrastrukturore etj, e si rrjedhojë ka edhe rritjen e ndikimit në mjedis. Ky zhvillim nuk mund të jetë i qëndrueshëm nëse nuk parashikon hapësira për mbrojtjen e mjedisit. Varësisht prej veprimtarisë, ndikimi i operatorëve ekonomik është i shprehur në të gjithë përbërësit e mjedisit si në ajër, ujë dhe tokë, biodiversitetet flore dhe faune.

Menaxhimi i Mbetjeve

Riviera bregdetare e qarkut Vlorë që përfshin bashkinë Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol karakterizohet nga një metabolizëm urban me potencial të lartë të zhvillimit ekonomik, bujqësor, turistik dhe industrial. Bashkia e Vlorës gjeneron në tërësi rreth 125 000t mbetje në vit, të cilat përbëjnë 14% të mbetjeve totale në rang kombëtar. Sasia e mbetjeve në këtë bashki bëhet e pamënaxhueshme përgjatë sezonit turistik, ku fluksi i përdorimit të të mirave dhe shërbimeve nga ana e turistëve shkon përtej kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike që bashkia Vlorë zotëron. Për këtë arsye, problematika e mbetjeve në këtë bashki kërkon një ndërhyrje të menjëhershme për një zgjidhje të shpejtë dhe afatgjatë.

Pjesa më e madhe e mbetjeve të krijuara janë të prirura të jenë substance inerte, në veçanti mbetje të ndërtimeve, por rreziqet më të mëdha janë të lidhura me vëllime të vogla,

9

<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=1339&token=a67d15e790640e735d8cbde38a0127b22b2aeeed9>

kryesisht industrial, të mbetjeve të rrezikshme. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në vend është akoma në një nivel të ulët, ku sasia e mbetjeve që riciklohen është 10%. Kryesisht mbetjet e mbetura asgjësohen në vend grumbullimet e mbetjeve. Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, në Shqipëri nuk ekziston infrastruktura bazë apo ajo plotësuese për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme. Për më tepër nuk ekzistojnë të dhëna mbi sasinë dhe rrymat e mbetjeve. Vendet për ndërtimin e objekteve për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme apo qendrave pritëse nuk janë përcaktuar ende në asnjë rajon apo qytet të vendit. Në bashkinë Vlorë, një zonë e ndjeshme mjedisore është dhe territory i ish Uzinës së Sodës Kaustike për zhivën, e cila pasi është pastruar nga mbetjet e trashëguara nga e kaluara, është kapsuluar dhe monitorohet pas mbylljes në bazë të kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore.

Zonat rurale nuk janë mbuluara plotësisht nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anë të rrugëve të cilat pastrohen nga ujërat dhe në këtë mënyrë zhvendosen në një pjesë tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore. Mbetjet bashkiake kanë një përqindje të lartë të mbetjeve organike dhe aktualisht në vendin tonë nuk kompostohen plotësisht këto mbetje me qëllim që të reduktohet sasia e tyre në venddepozitime. Mbetjet në rang bashkie kanë nevojë për një menaxhim të lartë të grumbullimit, transportimit, dhe rregullimit. Në përgjithësi, ka një mungesë të theksuar në diferencimin e mbetjeve të ndryshme, për të kryer më pas gjithë procedurat përkatëse të përpunimit. Sektori i mbetjeve paraqet një nga sfidat më të rëndësishme që ndesh Shqipëria.

Shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve janë mbi nivelet e programeve të tjera në Bashkinë Vlorë. Për vitin 2021 shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve janë realizuar me shpenzimet e vet Bashkisë dhe Buxhetit të Shtetit. Buxheti i Shtetit ka planifikuar gjithsej 695.4 milion lekë, për projektin “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Qarkun e Vlorës”, i cili është planifikuar të përfundoj në vitin 2023. Gjithashtu për vitin 2021 Buxheti i Shtetit ka planifikuar 190 milion lekë nga fondet e brendshme. Në Qarkun Vlorë është planifikuar investim “Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta” me një fond 600 milion lekë, nga të cilat 200 milion janë grant dhe 400 milion lekë kredi.

Plani Vendor¹⁰ i Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Vlorë shtrihet në një afat kohor 6-vjeçar 2022–2027 dhe paraqet perspektivat e zbatimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në gjithë territorin e bashkisë, duke përfshirë qytetin e Vlorës dhe njësitë administrative Qendër Vlorë, Orikum, Novoselë dhe Shushicë. Ky Plan përcakton rregullat për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve bashkiake që gjenerohen në territorin e bashkisë, duke marrë në konsideratë burimet e gjenerimit, sasinë, përbërjen e mbetjeve, infrastrukturën që mundëson proceset e menaxhimit të mbetjeve dhe skemat e organizimit të tyre. Ajo çfarë parashihet për të ardhmen në terma afatmesëm janë:

- Përmirësimi i performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në 20%;
- Rritja e përqindjes së mbetjeve që shkojnë në landfillet sanitare kundrejt mbetjeve të hedhura në venddepozitime të hapura në 60%.

¹⁰ <https://planifikimi.gov.al/index.php?id=795>

Ne zbatim të VKM Nr. 333 dt. 26.1.2011¹¹ “Per administrimin e venddepozitimeve rajonale të mbetjeve urbane”, është e domosdoshme hartimi i studimeve, projekt zbatimeve, si dhe ndertimit të venddepozitimeve të reja rajonale, ku landfilli i Vlorës merr një rëndësi të veçantë. Në plan parashikohet ndërtimi i një impianti me teknologji moderne që të diferencojë mbetjet dhe të djegë ato që nuk mund të trajtohen më tej, duke shfrytëzuar të gjitha cilësitë e këtyre mbetjeve, i vendosur në zonën industriale gjendet në rrugën për në fshatin Sherishte. Zhvillimi i një sistemi transporti për mbetjet, vendosjen e kontenerëve me një dendësi më të madhe si dhe një program për ndërgjegjësimin e komunitetit të Bashkisë Vlorë.

Miratimi i planit për ndërtimin e landfillit të Sheristës¹² është përzgjedhur si një zgjidhje e shpejtë dhe e domosdoshme për të sistemuar problematikën e menaxhimit të mbetjeve të Qarkut të Vlorës, por dhe të zonave përreth. Parashikohet që ky landfill të ketë kapacitet prej 580 mijë m³, ku impianti i trajtimit të ujrave të ndotura ka një kapacitet 75 m³/ditë, ndërsa impianti i riciklimit dhe paketimit 55 mijë tonë/vit.

Menaxhimi i sistemit ujor

Mbrojtja e tokës dhe përdorimit të saj për agrokulturë është një nga objektivat kryesorë të Bashkisë Vlorë, duke marrë në mbrojtje territoret ekzistuese prodhuese, dhe ato të dëmtuara që janë në procese rehabilitimi, për të shmangur kripëzimin e tyre, përmytjet, apo hedhjen e pakontrolluar të mbeturinave. Gjithashtu disa probleme kryesore në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve mund të përmendet fakti se edhe pse një ndër vendet me potencial me të lartë ujor në rajon, furnizimi me ujë në Shqipëri është i ulët në krahasim me vendet e tjera evropiane, veçanërisht në zonat rurale.

Sipas Strategjisë Kombëtare për Ndryshimet Klimaterike 2020-2030¹³, menaxhimi i baseneve të lumit Vjosë është pjesë e një veprimtari prioritare, e cila ka dhe mbështetje nga Bashkimi Europian nëpërmjet Kuadrit të Instrumentit Ndihmës Paranëtarësim (IPA). Për lumin Vjosa momentalisht nuk ka akoma një plan menaxhimi, por përgjatë 2022 Agjencia e Menaxhimit të Baseneve Ujore ka planifikuar hartimin e një dokumenti vlerësues të nevojave, që do të përbëjë edhe bazën kryesore për hartimin në vitin e ardhshëm të planit të menaxhimit për këtë lum.

Procesi i planifikimit të basenit ujor propozon sqarime rreth efektivitetit të strukturës aktuale të menaxhimit të ujit dhe përshkruan mandatin e ardhshëm të institucioneve të menaxhimit siç kërkohet nga nevojat e menaxhimit të basenit në tërësi. Në përgjithësi, kapacitetet administrative për menaxhimin e ujit janë të dobëta dhe të pamjaftueshme. Raporti i Monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit nënvizon se gratë në zonat rurale në Shqipëri shpesh përjashtohen nga proceset vendimmarrëse në lidhje me menaxhimin në përgjithësi, edhe pse punojnë dhe menaxhojnë burimet së bashku me burrat. Gjithashtu, të

¹¹ <https://turizmi.gov.al/menaxhimi-i-mbetjeve/>

¹² Përmbledhje jo teknike e raportit të thelluar të VNM-sw Aktiviteti: Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta urbane në rajonin e Vlorës.

¹³ https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-05/ALB_Raporti%20i%20Monitorimi%20i%20Planit%20Kombetar%20te%20Veprimit%20%281%29.pdf

rinjtë priren të përjashtohen nga vendimet, dhe veçanërisht gratë e reja. Kjo kulturë shoqëron gratë dhe burrat së bashku, por që çon në vendimmarrje më pak të diskutuara që nuk marrin parasysh përparësitë e grave, nevojat ose p.sh. idetë e biznesit etj.

Furnizimi me ujë ka ndërprerje ose nuk ka presion të qëndrueshëm në rrjet, një pjesë e madhe e ujit mbetet e pa faturuar gjë që vjen nga mungesa e ujë matësive, menaxhimit të dobët dhe efikasitetit të ulët të përdorimit të burimeve njerëzore si dhe mungesa e dezinfektimit të ujit, e cila sjell rreziqe potenciale për shëndetin e popullatës.

Kjo pasuri e madhe ujore sot po degradon sidomos në pjesën e saj që gjarpëron në këtë Bashki si pasojë e aktivitetit të kompanive të inerteve por edhe si pasojë e ndotjeve (ujërave të zeza etj) që vijnë nga komunat dhe fshatrat (rreth 40 të tilla) përreth luginës së tij¹⁴. Ndotja ka ndryshuar ekosistemin duke sjellë si pasojë më të dukshme, shfarosjen e rrapit lumor. Përveç ndotjes, përgjatë gjithë luginës së Vjosës po ndodh edhe shpyllëzimi masiv, tharja e rrapit lumor dhe gjuetia e paligjshme po çon drejt degradimit një prej pasurive më të rëndësishme ujore të Shqipërisë.

Lumi tjetër i rëndësishëm është edhe ai Shushicës apo siç njihet ndryshe lumi i Vlorës, i cili është një tributar i lumit Vjosa. Në pjesën e poshtme të rrjedhjes së këtij lumi, gërryerjet në shtratin e këtij lumi janë bërë një rrezik real për banorët që jetojnë në brigjet e tij. Kjo sjell pasoja kur bien reshje të shumta, lumi del nga shtrati duke përmbytur rrugën, por edhe shtëpitë pranë, duke prishur edhe tokat bujqësore me inertet që bart gjatë përmbytjeve. Gjithashtu të dy këta lumenj me ndotjen e tyre ndikojnë negativisht në pastërtinë e ujërave të detit në grykëderdhje. Kjo ndotje mund të sjellë pasoja negative edhe në ndotjen e ujërave të lagunave pranë.

Arsyet kryesore të përmbytjeve të zonave rurale të Vlorës lidhen me disnivele shpesh të tarraces së shtratit në zona të vazhdueshme, reshjet e përqëndruara, si dhe aftësia e ulët përcjellëse e kanalit rrjedhës për shkak të pjerrësisë së ulët dhe mbathjes së tabanit.

Pesë bashkitë përbërëse të cilat janë në kufij të lumit kryesor të Vjosës janë përkatësisht: Gjirokastrë (59%), Vlorë (22%), Fier (10%), Korçë (9%) dhe Berat (më pak se 1%)¹⁵.

Sipas studimeve të kryera, lumi Vjosa paraqitet me një nivel ndotje mikrobiologjike 2 herë më të lartë se vlerat e lejuara. Vlerat e konstatuara dëshmojnë një prezencë ndotjeje me origjinë fekale, për shkak të derdhjes së ujërave të ndotura urbane në lum, në rrjedhje të të cilat përdoren për ujitje. Përveç ndotjes së fekaleve, vihet re një prezencë ndotjeje të mbetjeve pesticidesh, nivel i lartë i metaleve të forta¹⁶. Indikator i lidhur edhe pse ndoshta

¹⁴ Top Channel. Lumi Vjosë, 80 për qind e rrjedhës së tij, e ndotur. 13.04.2012

<https://topchannel.tv/2012/04/13/lumi-vjose-80-per-qind-e-rrjedhes-se-tij-e-ndotur/>.

¹⁵ UNDP Albania (2017). Assessment of hydro-ecological and socio-economic systems of the Vjosa river under the EU Flood Protection Infrastructure Project – FPIP

file:///C:/Users/ADMIN/Downloads/Vjosa_River_Assessment.pdf.

¹⁶ Co-Plan (2016). Bashkia Fier. Dokumenti i raportit përfundimtar të vlerësimit strategjik mjedisor të planit të përgjithshëm të territorit të bashkisë.

https://issuu.com/coplan_tirane/docs/vleresimi_strategjik_mjedisor_fier.

jo në mënyrë të dukshme, me cilësinë e ujërave si sipërfaqësore ashtu dhe nëntokësore, është shëndeti publik.

Megjithatë, përveç përdorimit të drejtpërdrejt të ujit të pijshëm, ujërat sipërfaqësore të Vjosës përdoren për bujqësi. Pra përveç ndikimeve të drejtpërdrejta, shëndeti publik ndikohet indirekt dhe nga përdorimi i produkteve bujqësore të zonës. Ndikimi vlen së pari për të gjitha bashkitë të cilat janë në pellgun e Vjosës, pasi janë dhe konsumatorët e parë të këtyre produkteve bujqësore së bashku me përdorimin e ujërave nëntokësore për ujë të pijshëm.

Studimet e deritanishme tregojnë se pasojat më të shpeshta dhe të dëmshme të shëndetit të cilat vijnë si pasojë e ndotjes së ujërave, që lidhet me ekspozimin ndaj ujit të kontaminuar është sëmundja e zorrëve, siç është gastroenteriti vetëkufizues, i cili shpesh mund të jetë me kohëzgjatje të shkurtër. Transmetimi i patogjenëve që mund të shkaktojnë gastroenterit është biologjikisht i testuar dhe është analog me transmetimin dhe sëmundshmërinë si me përdorimin e ujit të pijshëm po ashtu dhe në aktivitete të tjera që lidhen me ujin¹⁷. Studime të tjera po ashtu kanë treguar se sëmundje respiratore akute febrile dhe sëmundje të përgjithshme të frymëmarrjes si dhe infeksione të veshit si dhe ndikim në mbrojtjen immune të syve, janë po ashtu sëmundje të lidhur me ndotjen e ujit¹⁸.

Bujqësia

Sistemi i Bujqësisë në bashki është i lidhur ngushtë me sistemin e ujit. Toka bujqësore kryesisht përbëhet nga dy lloje:

- zonat e sheshta të kulturave intensive bujqësore të cilat janë të ujitura nëpërmjet lumenjve. Ato janë të përqendruara në tre lugina të Vjosës, Novosela në veri, Shushica në lindje dhe Orikumi në jug. Disa toka bujqësore, kryesisht në veri të lagunës së Nartës janë krijuar nga tharja e një pjese të ligatinave në periudhën e socializmit. Kultivimet kryesore në zonën Novoselë, Shushicë, Qendër janë misri, fasulet, patatet, dhe zarzavatet.
- kultivimet kodrinore janë të përqendruara në dy pjesë, kryesisht në veri të Vlorës përgjatë formacioneve kodrinore të vendosura midis lagunës dhe luginës së Shushicës (fshatrat e Panajasë) dhe në jug, në pjesën lindore të luginës së Orikumit (në afërsi të Tragjasit dhe Dukatit). Kultivimet kryesore përgjatë luginave të vogla janë vreshtat dhe kodrinat e mbuluara me ullinj, pemë frutore dhe agrume. Prania e sistemeve të ujitjes është ende e dukshme në shumicën e tokave bujqësore (kanaleve, liqeneve artificial, etj).

¹⁷ Prüss A (1998) A review of epidemiological studies from exposure to recreational water. *International Journal of Epidemiology*, 27: 1–9.

¹⁸ Fleisher JM, Kay D, Wyer MD, Godfree AF (1998) Estimates of the severity of illnesses associated with bathing in marine recreational waters contaminated with domestic sewage. *International Journal of Epidemiology*, 27: 722–726.

Për shkak të emigrimit si dhe rënies së prodhimit bujqësor, dhe pas zhvendosjes së ekonomisë lokale drejt turizmit dhe ndërtimit, një pjesë e madhe e tokës bujqësore mbetet pak e përdorur, ndërsa operimi i sistemeve të ujitjes mbetet i pasigurt. Pothuajse gjithë toka bujqësore është privatizuar që nga vitet 1990 dhe i është ndarë përdoruesve të tij; domethënë banorëve dhe vendbanimeve fqinje. Sistemi bujqësor është shumë i rëndësishëm për të mbajtur popullsinë rurale të fshatrave të shumtë të zonës dhe mbështet zhvillimin e turizmit.

Bregdeti

Vlora është ndër bashkitë me gjatësinë më të madhe të vijës bregdetare, rreth 30% të vijës së përgjithshme bregdetare në shkallë vendi. Si e tillë, turizmi bregdetar është një nga motorët ekonomik që ndikojnë ndjeshëm në rritjen e mirëqënies së qytetarëve. Me zhvillimin e turizmit bregdetar, lindin dhe sfidat e mëtejshme mjedisore për sa i përket mirëmbajtjes së pastër të zonave publike dhe të frekuentuara nga qytetarët. Një nga problematikat më të mprehta të degradimit mjedisor në bregdet shkaktohet nga mbetjet urbane dhe kanalizimet e ujërave të zeza. Derdhja e kanaleve të ujërave të zeza nxit ngarkesat e larta bakteriologjike që i shkaktojnë ujtit erën e rëndë.

Një ndikim të dallueshëm në ndotjen e hapësirës detare të gjirit të Vlorës kanë edhe aktivitetet industrial të cilat ushtrohen në gji. Ndër të tjera, projekt propozimi i ndërtimit të një parku industrial i përbërë nga një TEC dhe Petroliferë¹⁹, janë potencialë të rrezikshëm të ndotjes së gjirit. Prania e mbetjeve industriale, dhe mbetjet vajore të anijeve të ndryshme të cilat i derdhen në det të hapur, hedhja e mbeturinave të ndryshme, mbetjeve spitalore, apo e detergjentëve larës të papërpunuara, janë

Sipas një artikulli të publikuar nga Instituti i Shkencave ALB²⁰, 45% e sasisë totale të ndotësve të ambientit detar shkaktohen nga aktivitetet e ndryshme të lidhura me veprimtarinë e anijeve, dhe 37% shkaktohen si pasojë e urbanizimit të zonës. Pra rreth 80% e ndotjeve të ambientit detar dhe bregdetar vjen si pasojë e veprimtarive të anijeve dhe urbanizimit të zonave industrial. Për këtë arsye, duhet të ushtrohen masa të rrepta për mbrojtjen e hapësirës publike në zonat apo rajone që ka një tendencë të rrijtes së këtyre aktiviteteve, siç mund të jetë dhe Gjiri i Vlorës. Gjithashtu ë gjirin e Vlorës, si pasojë e ritmeve të shpejta të zhvillimit, ka shumë ndërtime në të gjithë zonën e bregdetit ku pjesa më e madhe e të cilave nuk kanë kanalizime të ujërave të zeza dhe përdori gropat skeptike, duke infiltruar zonën e bregdetit dhe ndotur atë.

Gjetjet nga takimet me komunitetin

Gjatë diskutimeve vërehet mungesë e informacionit pasi me fjalën probleme të mjedisit konsiderohet vetëm hedhja apo prezenca e mbeturinave në hapësira të ndryshme publike dhe ndërgjegjësimi komunitar, sa i takon rritjes së edukimit rreth kujdesit për mjedisin, por mungon informacioni në lidhje me energjinë e rinovueshme. Gjithashtu, përgjatë diskutimeve u evidentuan dhe përgjegjësitë mjedisore që qytetari i thjeshtë duhet të ketë,

¹⁹ <https://www.zeriamerikes.com/a/6861752.html>

²⁰ http://alpa.mali-it.eu/pub/aktet/vol/vol3/Aktet_Vol_III_Nr_3_pp_366_371.pdf

por edhe bizneset që operojnë në bashkinë e Vlorës, sidomos në zonën e bregdetit. Shihet e nevojshme marrja e masave ndaj faktorëve që ndosin jo vetëm mjedisin por dhe peisazhin natyror bregdetar dhe malor i cili shërben si motorri i ekonomisë së zonës.

Aleanca Feministe Mjedisore e Vlorës nënvizoi më tej nevojën e shtimit të koshave të mbetjeve dhe përmirësimit të tyre, sidomos gjatë sezonit turistik. Prej vitesh, bashkia e Vlorës ka mbeturinat e hedhura ne ambientet publike armikun e saj numër 1. Kjo ndotje publike bëhet më e papërmbajtshme gjatë sezonit turistik të verës, ku pushuesit nuk shohin alternativë tjetër për të hedhur mbetjet përveçse ambientit të hapur. Ndotja publike në sezonin turistik nxit dhe përhapjen e aromave të pakëndshme që krijohen për shkak të temperaturës.

Bashkia Vlorë vuan gjithashtu dhe nga mungesa e hapësirave të gjelbërta me pemë të larta, të cilat mundësojnë qëndrimin në sheshpushime me hije. Këto hapësira, edhe kur ndodhen, zihen nga makina të pushuesve të cilët për shkak të mungesës së zonave të parkimit zgjedhin të ndalojnë aty. Për këtë arsye, banorë të bashkisë Vlorë dhe pushues kanë vështirësi të gjejnë zona pushimi publike që mundësojnë hijen gjatë orëve të nxehta të ditës në sezonin turistik, duke rrezikuar shëndetin e tyre.

Fushatat advokuese që po realizohen

Aktualisht, në Bashkinë Vlorë po organizohet një fushatë advokuese mjedisore që po zbatohet për rritjen e ndërgjegjësimit qytetarë për mjedisin si edhe shtimin e hapësirave të gjelbra.

Në vitin 2022, në bashkëpunim me organizatën jo-fitimprurëse “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, është themeluar, në bashkëpunim me banorë të qytetit të Vlorës dhe organizata lokale, Aleanca Feministe Mjedisore e Vlorës. Gjatë takimeve të zhvilluar në kuadër të Aleancës Feministe Mjedisore, është diskutuar rreth problematikave më të shpeshta që banorët hasin në përditshmërinë e tyre dhe se si këto problematika ndikojnë në mjedis dhe jetën sociale. Anëtarët e Aleancës Feministe Mjedisore ranë në përfundim të disa sfidave aktuale që ata hasin në bashkinë Vlorë dhe paraqiten tek rekomandimet më poshtë.

Konkluzione

Rekomandime - duke u bazuar ne gjetjet por edhe ne rekomandimet e fundit qe ka dhënë BE në progres raport.

Shqipëria dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) në Qershor 2006. MSA ka hyrë në fuqi në 1 Prill 2009. Në bazë të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, nenit 108 “Mjedisi” “Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Bashkëpunimi përqëndrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e komunitetit për fushën e mjedisit. Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, kryhet në përputhje

me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), në të cilin Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) kontribuon për kapitullin 27 të tij “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”.

Më 25 Mars 2020, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së miratoi hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë. Vendimi i Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së u miratua nga Këshilli Evropian më 26 Mars 2020. Këshilli mandatoi Komisionin Evropian për të vazhduar dhe përfunduar procesin e shqyrtimit analitik të acquis së BE-së, duke u nisur nga grupimi i thelbësoreve. Gjatë viteve 2018 dhe 2019, Komisioni Evropian zhvilloi të gjitha takimet shpjeguese të acquis komunitare për të 33 kapitujt.

Takimi shpjegues për kapitullin 27 (“Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”), u zhvillua më 13 -17 Maj 2019, në Bruksel. Në kuadër të përgatitjes për hapjen e negociatave për anëtarësim, qeveria shqiptare po vijon krijimin e strukturës negociuese për negociatat, përfshirë grupet ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, me Nr. 94, datë 20.5.2019, për “Ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian”, për kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucion kryesues, për këtë kapitull negociues.

Kapitulli 27 është ndër kapitujt më të rëndësishëm të acquis së BE-së duke përfshirë 73 Direktiva dhe Rregullore, të cilat përbëjnë kuadrin ligjor të BE-së për fushën e Mjedisit dhe Ndryshimeve Klimatike. Kapitulli 27 është një kapitull ndërsektorial ku përfshihen një sërë ministrish linje dhe agjencish të pavarura, të cilat ushtrojnë kompetenca në fushën e mjedisit dhe nënfushat përkatëse të tij. Të gjitha detyrimet raportuese, planifikimin e politikave, strategjitë si dhe monitorimin e zbatimit të tyre e koordinon MTM në cilësinë e institucionit lider për këtë kapitull. Në bazë të metodologjisë së dakordësuar për punën përgatitore deri në takimet bilaterale, në kuadër të procesit të shqyrtimit analitik të acquis, MTM është në proces vlerësimi të kuadrit ligjor të përafuar me legjislacionin e BE-së për kapitullin 27 dhe kapaciteteve institucionale që rrjedhin si detyrim nga implementimi i këtij kuadri.

Bazuar në sa më sipër, do të ishte e rekomandueshme për Bashkinë Vlorë që:

- Shtimi i koshave të mbeturinave në zonat turistike, urbane, dhe dytësore.
- Rritja e frekuencës së mbledhjes së mbeturinave nga Bashkia Vlorë, sidomos gjatë sezonit turistik.
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe të rinjve për të mbajtur pastër mjedisin, përdorimin e materialeve ricikluese, dhe denoncimin e ndotësve të paligjshëm.
- Ndërgjegjësimi i bizneseve për të plotësuar standardet për të mbajtur pastër mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve të tyre, veçanërisht në periudhën e sezonit turistik.
- Ndërgjegjësimi i Bashkisë Vlorë në monitorimin dhe kërkesë-llogaridhënies të bizneseve që ndosin mjedisin, apo që përdorin kanalizime të ujrave të ndotur jashtë standardeve të kërkuara.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe nxitja e pastrimit të zonave të plazheve publike.
- Shtimi i zonave të gjelbërta me pemë të larta që mundësojnë hijen gjatë stinës së nxehtë të verës.

- Rritja e numrit të parkingjeve publike për të zvogëluar trafikun e rënduar gjatë sezonit veror turistik, si dhe për të minimizuar ndotjen që shkaktojnë makinat gjatë qëndrimit pa lëvizur.

Referenca

Porti Vlorë, faqja zyrtare: <https://www.portivlore.com/index.php/statistika/>

Co-Plan (2016). Bashkia Fier. Dokumenti i raportit përfundimtar të vlerësimit strategjik mjedisor të planit të përgjithshëm të territorit të bashkisë.

https://issuu.com/coplan_tirane/docs/vleresimi_strategjik_mjedisor_fier.

Fleisher JM, Kay D, Wyer MD, Godfree AF (1998) Estimates of the severity of illnesses associated with bathing in marine recreational waters contaminated with domestic sewage. International Journal of Epidemiology, 27: 722–726.

<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=5154&token=da636af1a1a4ffe0d0973a5cfc7eedbca62f49cc>

<https://pushtetivendor.reporter.al/wp-content/uploads/2015/05/Bashkia-Vlore.pdf>

https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-

[2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf](https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf)

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: <https://turizmi.gov.al/menaxhimi-i-mbetjeve/>

Plani I Planifikimit të Përgjithshëm Vendor Vlorë:

<https://planifikimi.gov.al/index.php?id=795>

Prüss A (1998) A review of epidemiological studies from exposure to recreational water. International Journal of Epidemiology, 27: 1–9.

Pwrmbledhje jo teknike e raportit të thëlluar të VNM-së Aktiviteti: Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta urbane në rajonin e Vlorës.

Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri: https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-05/ALB_Raporti%20i%20Monitorimi%20i%20Planit%20Kombetar%20te%20Veprimit%20%281%29.pdf

Revista shkencore Alb-Shkenca: <http://alpa.mali->

[it.eu/pub/aktet/vol/vol3/Aktet_Vol_III_Nr_3_pp_366_371.pdf](http://alpa.mali-it.eu/pub/aktet/vol/vol3/Aktet_Vol_III_Nr_3_pp_366_371.pdf)

Top Channel. Lumi Vjosë, 80 për qind e rrjedhës së tij, e ndotur. 13.04.2012

<https://topchannel.tv/2012/04/13/lumi-vjose-80-per-qind-e-rrjedhes-se-tij-e-ndotur/>.

UNDP Albania (2017). Assessment of hydro-ecological and socio-economic systems of the Vjosa river under the EU Flood Protection Infrastructure Project – FPIP

file:///C:/Users/ADMIN/Downloads/Vjosa_River_Assessment.pdf.

Zëri i Amerikës: <https://www.zeriamerikes.com/a/6861752.html>